

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTERISE DURRES

Nr. 113 Rep.

Nr. 55 Kol.

NOTERE

Merita ISUFAJ

L.11, Rr.A.Goga, Durres

PULLE TARIFE



## DESHMI TRASHEGIMIE LIGJORE

Ne Durres, sot me date 29 Janar 2015 (dymije e pesembedhjete), dite e enjte, une Merita Isufaj, notere prane Dhomes se Noterise Durres, me adrese ne L.11, Rr.A.Goga, Perballe Gjykates Durres, mora ne shqyrtim kerkesen dhe provat shkresore, te paraqitura nga:

**KERKUESE:** Ervehe KUQI, atesia Ahmet, amesia Edije, e gjinise femer, e dtl.04.02.1954, lindur ne Durres, me gjendje civile e ve, me shtetesi shqiptare, me numer personal F45204028I, banuese ne L.11, Rr.Skender Xhemali, Nr.34, Durres, ne cilesine e bashkeshortes se trashegimlensesit Petrit Kuqi, identifikuar me Leternjoftimin nr.028470469, leshuar me 16.02.2010, madhore dhe me zotesi te plote juridike e per te vepruar.

**ME OBJEKT:** *Leshimin e Deshmise se Trashegimise Ligjore per  
Trashegimlensesin Petrit KUQI;*

**BAZA LIGJORE:** Nenet 317, 318, 348, 360 dhe 361 te Ligjit nr.7850, date 29.07.1994 "Kodi Civil i RSH", te ndryshuar; Ligji nr.121 dt.18.04.2013 "Per disa shtesa dhe ndryshime ne Ligjin nr.7850, date 29.07.1994 "Kodi Civil i RSH", te ndryshuar; Ligji nr.7829 dt.01.06.1994 "Per Noterine", te ndryshuar; Ligji nr.131 dt.29.04.2013 "Per disa shtesa dhe ndryshime ne Ligjin "nr.7829 dt.01.06.1994 "Per Noterine", te ndryshuar; Urdheri nr.356 date 04.09.2013 i Ministrit te Drejtesise;

Pasi administrova provat shkresore,

### V Ë R E J:

Se kerkuesja Ervehe Kuqi, ka depozituar ne zyren time noteriale, nje kerkese me ane te se ciles kerkohet "Leshimi i Deshmise se Trashegimise ligjore per trashegimlensesin Petrit Kuqi". Nga certifikata e vdekjes, me numer serie 005687374, leshuar me 16.01.2015, nga ZGJC nr.2 e Bashkise Durres, rezulton se trashegimlensesi Petrit Kuqi, ka vdekur me date 24.04.2014, ne Durres, me vendbanim te fundit, ne Durres, fakt qe konfirmohet dhe nga kerkuesja. Prandaj, ne baze te ketij fakti, duke u bazuar ne nenin 348 te Kodit Civil te vitit 1994, te ndryshuar, i cili percakton se "Deshmia e trashegimise ligjore leshohet nga noteri i njesise vendore ku ka pasur vendbanimin e fundit trashegimlensesi", konstatoj se une noteria kam kompetencen per leshimin e kesaj deshmie.



Nga çertifikata familjare me numer serie 007114696, leshuar me 16.01.2015, nga ZGJC nr.2 e Bashkise Durres e çertifikatat e tjera te administruara, provohet se kerkuesja eshte bashkeshortja e trashegimlensit dhe si e tille, ka interes te ligjshem, pra legjitimohet per te kerkuar leshimin e kesaj deshmie trashegimie.

Ndersa, prej informacionit qe mora nga Dhoma Kombetare e Noterise, nepermjet Regjistrat Noterial Shqiptar, me date 28.01.2015, nga verifikimi i Regjistrat Kombetar te Testamenteve, nuk rezulton qe trashegimlensit te kete lene testament.

Prandaj, sa me siper, une noteria ne baze te nenit 317 te Kodit Civil te vitit 1994, te ndryshuar, proçedoj me leshimin e deshmise se trashegimise ligjore.

Nga provat shkresore te paraqitura dhe te depozituara prane kesaj zyre, rezulton se: -Trashegimlensit Petrit Kuqi, atesia Ramiz, amesia Mile, i gjinise mashkull, i dtl.31.07.1947, lindur ne Durres, me gjendje civile i martuar, me shtetesi shqiptare, me numer personal E70731032R, **ka vdekur me date 24.04.2014**, me vendbanim te fundit, ne Durres, siç vertetohet nga çertifikata e vdekjes, me numer serie 005687374, leshuar me 16.01.2015, nga ZGJC nr.2 e Bashkise Durres; Meqenese ne çertifikaten e marteses (nga Akti) me nr.serie 005251967, leshuar me 16.01.2015, nga ZGJC, Rrethit Durres, nuk rezultojne shenime, trashegimlensit prezumohet se ka qene i martuar ne regjimin pasuror martesor te bashkesise ligjore, fakt qe konfirmohet dhe nga kerkuesja, ne cilesine e bashkeshortes se trashegimlensit.

Gjate shqyrtimit te kerkeses, une noteria bazohem ne nenet 318 dhe 318/2 te Kodit Civil te vitit 1994, te ndryshuar, sipas te cilit "*Trashegimia çelet kur vdes trashegimlensit. Trashegimia rregullohet sipas ligjit te kohes kur eshte çelur.*"

Prandaj, sa me siper, meqenese nga çertifikata e vdekjes se te ndjerit, rezulton se ai ka vdekur me date 24.04.2014, ne po kete date eshte bere dhe çelja e trashegimise, prandaj ajo do te rregullohet me dispozitat perkatese per trashegimine, te Ligjit nr.7850 date 29.07.1994 "Kodi Civil i RSH", te ndryshuar, i cili perfaqeson ligjin e kohes kur eshte çelur trashegimia.

Sipas nenit 361 te Kodit Civil te vitit 1994, te ndryshuar, "*Ne rradhe te pare thirren ne trashegim femijet dhe bashkeshorti i afte ose i paafte per pune, duke trasheguar secili ne pjese te barabarta*".

Nga çertifikata e marteses (nga Akti) me nr.serie 005251967, leshuar me 16.01.2015, nga ZGJC, Rrethit Durres, çertifikata familjare me numer serie 007114696, leshuar me 16.01.2015, nga ZGJC nr.2 e Bashkise Durres dhe çertifikatat e tjera te administruara prane kesaj zyre, rezulton se trashegimlensit ka qene i lidhur ne martese ligjore me shtetasen Ervehe Kuqi dhe se nga martesa e tyre, kane lindur dy vajzat, Gentiana Taullai (Kuqi-mbiemri i vajzerise) dhe Brunilda Bardhi (Kuqi-mbiemri i vajzerise).

Ne baze te çertifikatave personale te te gjithë trashegimtareve, te administruara, vertetohet fakti juridik i qenies gjalle te trashegimtareve, prandaj ne baze te nenit 320 te Kodit Civil te vitit 1994, te ndryshuar, trashegimtarete kane zotesi per te trasheguar.



Nga dokumentacioni i administruar dhe nga deklarimi i kerkueses, nuk rezulton qe ndonjeri nga trashegimtarete te kete vdekur para trashegimlensit, te jete bere i padenje per te trasheguar, te kete hequr dore nga trashegimia, apo te jete perjashtuar nga trashegimia. Gjithashtu, kerkuesja me deklaroi se trashegimlensit nuk ka trashegimtare te tjere ligjore, perveç atyre qe rezultojne nga dokumentacioni i depozituar prej saj, administruar prane kesaj zyre.

Prandaj, per sa me sipër, rezulton se trashegimtare ligjore te radhes se pare dhe te vetme te trashegimlensit Petrit Kuqi, jane bashkeshortja dhe dy vajzat e tij, konkretisht:

**1-Ervehe Kuqi**, atesia Ahmet, amesia Edije, e gjinise femer, e dtl.04.02.1954, lindur ne Durres, me gjendje civile e ve, me shtetesi shqiptare, me numer personal F45204028I, me adrese ne Durres, provuar nga çertifikata personale, me numer serie 005687371, leshuar me 16.01.2015, nga ZGJC nr.2 e Bashkise Durres, ***bashkeshortja***;

**2-Gentiana Taullai (Kuqi-mbiemri i vajzerise)**, atesia Petrit,amesia Ervehe, e gjinise femer, e dtl.15.02.1983, lindur ne Durres, me gjendje civile e martuar, me shtetesi shqiptare, me numer personal I35215084G, me adrese ne Durres, provuar nga çertifikata personale, me numer serie 005687372, leshuar me 16.01.2015, nga ZGJC nr.2 e Bashkise Durres, ***e bija***;

**3-Brunilda Bardhi (Kuqi-mbiemri i vajzerise)**, atesia Petrit,amesia Ervehe, e gjinise femer, e dtl.15.08.1986, lindur ne Durres, me gjendje civile e martuar, me shtetesi shqiptare, me numer personal I65815077V, me adrese ne Durres, provuar nga çertifikata personale me numer serie 005669856, leshuar me 16.01.2015, nga ZGJC nr.1 e Bashkise Durres, ***e bija***;

te cilat trashegojne ne pjese te barabarta, prej 1/3 pjese te pandare secila te pasurise trashegimore dhe po ne te njejtat raporte, pergjigjen edhe per detyrimet qe rendojne mbi pasurine trashegimore te trashegimlensit.

Nga sa me sipër, une noteria konkludoj se kerkesa e kerkueses eshte e drejte dhe e bazuar ne prova dhe ne ligj, prandaj si e tille duhet te pranohet plotesisht.

### PER KETO ARSYE

Bazuar ne nenet 317, 318, 348, 360 dhe 361 te Ligjit nr.7850, date 29.07.1994 "Kodi Civil i RSH", te ndryshuar, Ligjit nr.121 dt.18.04.2013 "Per disa shtesa dhe ndryshime ne Ligjin nr.7850, date 29.07.1994 "Kodi Civil i RSH", te ndryshuar, Ligjit nr.131 dt.29.04.2013 "Per disa shtesa dhe ndryshime ne Ligjin nr.7829 dt.01.06.1994 "Per Noterine", te ndryshuar.

### VENDOSA

1.Pranimin e kerkeses.

2.Leshimin e deshmise se trashegimise ligjore per **trashegimlensin Petrit Kuqi**, duke percaktuar si trashegimtare ligjore te radhes se pare,si vijon:



1. Ervehe Kuqi, bashkeshortja
2. Gentiana Taullai (Kuqi-mbiemri i vajzerise), e bija
3. Brunilda Bardhi (Kuqi-mbiemri i vajzerise), e bija

te cilat trashegojne ne pjese te barabarta, prej 1/3 pjese te pandare secila, te pasurise trashegimore te trashegimlensesit dhe ne po ato raporte, trashegimtarete pergjigjen edhe per detyrimet qe rendojne mbi pasurine trashegimore te trashegimlensesit.

Kerkuesja mori dijene per regjistrimin e kesaj Deshmie trashegimie, prane ZVRPP te qarqeve ku ndodhet pasuria trashegimore e trashegimlensesit, brenda afatit ligjor 30 ditor, duke filluar ky afat nga data e sotme e leshimit te kesaj deshmie, sepse me kalimin e ketij afati, detyrohet qe, pervec tarifes se regjistrimit, te paguaje dhe tarifen shtese te voneses.

Kjo deshmi trashegimie u hartua ne 4 (kater) origjinale, nga te cilat njera i leshohet trashegimtares-kerkuese, 2(dy) origjinalet e tjere mbahen prane kesaj zyre per t'iu dorezuar trashegimtareve te tjere te trashegimlensesit, sipas kerkeses se tyre. Nje origjinal mbahet prane kesaj zyre, i depozituar ne arkiven noteriale, bashkelidhur me dokumentacionin perkates, ne te cilen aplikohet tarifa e pulles.

U leshua ne Durres, sot me date 29.01.2015

NOTERE  
Merita ISUFAJ

